

# BEI NË NJË VËSHTRIM

2024



Banka Evropiane  
e Investimeve

## **BEI në një vështrim**

© Banka Evropiane e Investimeve, 2024.

98-100, boulevard Konrad Adenauer

L-2950 Luxembourg

+352 4379-1

[info@eib.org](mailto:info@eib.org)

[www.eib.org](http://www.eib.org)

[twitter.com/eib](https://twitter.com/eib)

[facebook.com/europeaninvestmentbank](https://facebook.com/europeaninvestmentbank)

[youtube.com/eibtheubank](https://youtube.com/eibtheubank)

Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Të gjitha pyetjet mbi të drejtat dhe licencimin duhet të dërgohen te [publications@eib.org](mailto:publications@eib.org).

Për informacion të mëtejshëm lidhur me aktivitetet e BEI-t, konsultohuni me faqen e internetit: [www.eib.org](http://www.eib.org).

Mund gjithashtu të kontaktoni nga [info@eib.org](mailto:info@eib.org).

Merrni buletin tonë elektronik në [www.eib.org/sign-up](http://www.eib.org/sign-up).

© Meritat e fotos: Shutterstock, Artem Hetman/UNDP Ukraine, CTP, RocSys, Darcy Levison/WHO, VARJO.

Botuar nga Banka Evropiane e Investimeve.

Printuar në letër FSC®.

# BEI NË NJË VËSHTRIM

Banka Evropiane e Investimeve (BEI) është banka e Bashkimit Evropian dhe një nga ofruesit më të mëdhenj të financimit për masat për klimën në botë.

Që nga themelimi ynë në vitin 1958, BEI ka investuar mbi një trilion euro në projekte në Evropë dhe vende në mbarë botën. Duke qenë se masat për klimën një pjesë e madhe e aktiviteteve tona, ne fokusohemi gjithashtu te mjedisi, zhvillimi, novacioni dhe aftësitë, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM), infrastruktura dhe kohezioni.

Fondi Evropian i Investimeve (FEI), i cili është pjesë e Grupit të BEI-t, është i specializuar në mbështetjen e NVM-ve me financimin e ndërmarrjeve të reja, rritjes, novacionit, kërkim-zhvillimit, punësimit dhe zhvillimit rajonal.

BEI punon me institucione të tjera të BE-së për të nxitur integrimin evropian, për të promovuar zhvillimin në Bashkimin Evropian dhe për të mbështetur politikat e BE-së. Në të gjithë Evropën, investimet tona i sjellin më afër vendet e BE-së.

Puna jonë shtrihet përtej Evropës në mbi 160 vende. Nëpërmjet BEI Globale, që u ngrit në vitin 2022 për të rritur ndikimin e financave tona të zhvillimit, ne ndihmojmë në adresimin e sfidave globale dhe nxisim zhvillimin dhe mundësitë anëmbanë botës.

# NDIKIMI YNË NË VITIN 2023

**320  
miliardë  
euro**

investime të mbështetura  
nga Grupi i BEI-t

**87,85  
miliardë  
euro**

financime të Grupit të BEI-t

**49  
miliardë  
euro**

financime të projekteve  
të gjelbra

**49,8  
miliardë  
euro**

të mbledhura në tregjet e  
obligacioneve

**20  
miliardë  
euro**

në ndërmarrjet e vogla dhe  
të mesme

**26,8  
miliardë  
euro**

në energji të qëndrueshme  
dhe burime natyrore

**19,76  
miliardë  
euro**

në novacion, teknologji  
digjitale dhe njohuri

**5,4 milionë**

vende pune për ndërmarrjet  
e vogla dhe të mesme

**4,9 milionë**

njerëz pinë ujë më të sigurt



## Financimi i BEI-t në vitin 2023 arriti vlerën 75,14 miliardë euro, duke përfshirë 8,44 miliardë euro nga BEI Globale

**13,8 milionë**

shtëpi me energji elektrike

**17,3 milionë**

njerëz përfitojnë nga  
përmirësimi i infrastrukturës

**11,6 milionë**

abonime 5G

**254 milionë**

udhëtime shtesë me  
transport publik

**1,5 milionë**

persona të mbrojtur nga  
përmytjet

**21 700 MW**

kapacitet gjenerimi korrenti  
të rinovueshëm

**42 988 km**

linja elektrike të instaluar apo  
modernizuara

**13 milionë**

njehsorë inteligjentë korrenti  
të instaluar

**130,6 milionë**

individë përfitues shërbimesh  
më të mira shëndetësore,  
duke përfshirë vaksinimet



**Kompleksi sportiv dhe rehabilitues "Kolos" për personat me aftësi të kufizuara u hap në maj 2023 në Reshetilivkë, Ukrainë, pas një rindërtimi të gjerë të mbështetur nga BEI.**





# MBËSHTETJE PËR UKRAINËN

Pushtimi në shkallë të plotë i Ukrainës nga Rusia vazhdon të shkaktojë vuajtje të tmerrshme, shkatërrim masiv të infrastrukturës, qyteteve dhe komuniteteve dhe pengesa të mëdha në ekonomi. BEI u qëndron pranë autoriteteve ukrainase dhe popullit të Ukrainës. Ne mbështesim një Ukrainë të pavarur.

Si pjesë e një përgjigjeje të koordinuar të BE-së dhe ndërkombëtare ndaj kësaj krize, banka ka mobilizuar mbështetje financiare përmes Paketës së Solidaritetit të BEI-t për Ukrainën për të ndihmuar qeverinë në përmbushjen e nevojave urgjente për likuiditet, duke garantuar ofrimin e ushqimeve, artikujve mjekësorë dhe karburantit për ukrainasit.

Asistenca e ofruar nga BEI në vitin 2023 u përqendrua në Fondin e BE-së për Ukrainën, i cili jep ndihmë në të gjithë sektorët, duke përfshirë investimet e kapitalit sipërmarrës për sektorin privat.

Shtetet Anëtare të BE-së premtuan më shumë se 400 milionë euro për këtë fond të BEI-t për sektorë si shëndetësia, transporti, arsimi, siguria kibernetike, infrastruktura sociale kritike dhe sektori privat.

Asistenca tjetër e BEI-t për Ukrainën përfshin:

- një garanci të BE-së që i lejon bankës të vërë në dispozicion 100 milionë euro financim për rimëkëmbje të shpejtë, si p.sh. për riparimet e infrastrukturës komunale ose të energjisë;
- 100 milionë euro ndihmë konsulence dhe teknike nga fondet e veta të BEI-t për të ndihmuar Ukrainën të përgatisë projekte rimëkëmbjeje.



**Kompania logjistike CTP po i transformon çatitë e objekteve të saj në ferma masive të energjisë diellore, duke ulur kostot dhe emetimet për banorët e saj. BEI e mbështeti CTP me një kredi prej 200 milionë eurosh në 2023.**







# KLIMA DHE ENERGJIA

Ndryshimet klimatike janë sfida më e madhe globale e brezit tonë. Arritja e objektivave klimatike do të përcaktojë mirëqenien e fëmijëve tanë. Objektivat e BEI-t për klimën dhe energjinë po vendosin standarde të reja në Evropë dhe më gjerë. Ne nuk i mbështesim projektet e karburanteve fosile dhe u kushtojmë mbi 50% të investimeve tona masave për klimën dhe qëndrueshmërisë.

Investimet e BEI-t mbështesin tranzicionin e gjelbër. Si banka e BE-së për klimën, BEI po ndihmon në përmbushjen e angazhimeve të Marrëveshjes së Parisit - traktatit ndërkombëtar për ndryshimet klimatike - dhe Objektivave të OKB-së për Zhvillim të Qëndrueshëm. Ne premtuam 1 trilion euro investime për klimën dhe mjedisin deri në vitin 2030 dhe jemi në rrugën e duhur për ta përmbushur këtë objektiv.

Operacionet e BEI-t përshpejtojnë rritjen e gjelbër dhe dekarbonizimin e ekonomive. Ne mbështesim projektet për efikasitetin e energjisë dhe energjinë e rinovueshme, të cilat ndihmojnë në reduktimin e emetimeve të karbonit dhe forcimin e sigurisë sonë energjetike.

Investimet e BEI-t luftojnë gjithashtu efektet e ndryshimeve klimatike në komunitetet e cënueshme, duke mbrojtur biodiversitetin dhe duke promovuar bujqësinë e qëndrueshme. Ne i ruajmë burimet natyrore dhe po e bëjmë mjedisin të sigurt për brezat e ardhshëm.

Çdo projekt që BEI mbështet, qoftë për novacion, biznese të vogla apo infrastrukturë, duhet të jetë në përputhje me qëllimet tona klimatike. Ne mbështesim projektet që mbrojnë mjedisin ku do të jetojnë fëmijët tanë, edhe ndërsa sjellim risi për ta bërë të ardhmen e tyre më të begatë.



**ROCSYS**

**ROCSYS**

**Kompania holandeze Rocsys mori një kredi prej 18 milionë eurosh nga BEI në 2023 për të zhvilluar pajisje me krahë robotikë që lidhin kabllo të karikimit me automjetet duke përdorur sensorë prekëse për të imituar veprimin e njeriut.**



# NOVACION

Novacioni është zemra që rreh e përparimit të njeriut. Ai përmirëson mirëqenien, nxit prosperitetin dhe u sjell përfitime brezave të ardhshme. Është thelbësor për rritjen ekonomike dhe punësimin.

Grupi i BEI-t është i përkushtuar për të thyer barrierat e investimeve dhe për të ndihmuar Bashkimin Evropian të marrë drejtimin në valën e ardhshme të novacionit. Novacioni e mban Evropën konkurruese dhe krijon vende pune me vlerë të lartë. BEI mbështet shumë faza të novacionit, duke mbështetur idetë që përmirësojnë standardet e jetesës.

Ne mbështesim kërkim-zhvillimin në shkallë të gjerë, si dhe firmat e vogla e të specializuara. Investimet tona në sektorë si telekomunikacionet, aviacioni, mjekësia dhe digjitalizimi janë një vulë miratimi që tërheq financime shtesë nga sektori privat për këto projekte.

Me kreditë e BEI-t, universitetet ndërtojnë dhe zgjerojnë objektet e tyre kërkimore. Kompanitë e reja rrisin stafin dhe përmirësojnë pajisjet e tyre. Idetë më të fundit kthehen në suksese biznesi.





**Në vitin 2023, një kredi prej  
1 milion eurosh nga BEI ndihmoi në  
riparimin e shkollës V.I. Vernadskyi  
në Poltava Oblast, Ukrainë.**

# PËRFSHIRJE

BEI përkrah bizneset e vogla dhe të rinjtë, dhe mbështet gratë sipërmarrëse, duke u dhënë atyre akses në kredi dhe trajnime. Ne bëjmë të mundur që njerëzit me të ardhura të ulëta, të vetëpunësuarit dhe mikrondërmarrjet të marrin financime dhe këshilla biznesi për t'u siguruar që projektet e tyre të kenë sukses.

BEI ka zgjeruar mbështetjen për institucionet lokale mikrofinanciare në rajone ku njerëzit shpesh nuk kanë akses në banka. Kur njerëzit kanë mundësinë të marrin kredi, bizneset punësojnë më shumë punonjës, gratë bëhen të pavarura, zhvendosja reduktohet dhe familjet mund të dalin nga varfëria.

Ne ndihmojmë që askush të mos mbetet pas. Ne ofrojmë shtëpi të sigurt dhe me efikasitet energjie për popullatat me të ardhura më të ulëta. Investimet tona krijojnë mundësi në mbarë botën për komunitetet rurale dhe për gratë e fëmijët.





**BEI ka miratuar një kredi prej 750 milionë eurosh në shtator 2023 për të rehabilituar afro 22 kilometra linja hekurudhore për pasagjerë në Aleksandri, duke shtuar vagonë të rinj, duke rinovuar stacionet dhe duke konvertuar motorët me naftë në sisteme me energji elektrike.**





# PËRKUSHTIM DHE EKSPERTIZË PËR NJË TË ARDHME TË QËNDRUESHME

BEI jep llogari përpara qytetarëve të BE-së. Ajo mbështet projekte që promovojnë prioritetet dhe objektivat e Bashkimit Evropian, duke përfshirë klimën dhe qëndrueshmërinë mjedisore, novacionin dhe aftësitë, infrastrukturën, NVM-të, kohezionin dhe zhvillimin.

Stafi ynë përfshin ekonomistë, inxhinierë, analistë financiarë dhe specialistë të klimës që punojnë çdo ditë me ekspertë vendas, institucione dhe qeveri në të gjithë globin.

BEI është financiarisht autonome dhe mbledh fonde duke emetuar obligacione në tregjet ndërkombëtare të kapitalit. Vlerësimi ynë i shkëlqyer në kredite na lejon të mbledhim fonde me përqindje të mira dhe këto përfitime u kalojnë klientëve.

Zakonisht, ne nuk japim kredi më shumë se gjysmën e vlerës së kostos së një projekti. Përfshirja e BEI-t ka për qëllim të veprojë si një katalizator që tërheq sektorin privat, duke rritur investimet.

Ekspertët e BEI-t për tregun e kapitaleve krijuan dhe zhvilluan tregjet e gjelbra dhe të qëndrueshme të obligacioneve. Ne jemi emetuesi më i madh mbishtetëror i obligacioneve të gjelbra, të cilat mbështesin energjinë e rinovueshme, efikasitetin e energjisë, ujin e pastër dhe kanalizimet.



**Në vitin 2023, BEI bashkëpunoi me Komisionin Evropian dhe Fondacionin Bill & Melinda Gates për të mbuluar vaksinat e poliomielitit për gati 370 milionë fëmijë çdo vit në Afrikë.**



# BEI GLOBALE

Sfidat dhe mundësitë e mëdha të sotme janë globale sepse të gjitha ekonomitë tona janë të ndërlidhura. Prosperiteti në një rajon promovon prosperitet kudo.

BEI Globale, krahu i zhvillimit të BEI-t, shfrytëzon të gjitha burimet e bankës për të përballuar operacionet e saj jashtë Bashkimit Evropian. Ai është krijuar për të nxitur partneritete të forta dhe të fokusuar me Team Europe, e përbërë nga Shtetet Anëtare dhe institucionet e BE-së për qeverinë dhe financat.

Si pjesë e Team Europe, ne mbështesim Global Gateway, një strategji evropiane për të investuar në projekte të qëndrueshme dhe me cilësi të lartë në mbarë botën në dobi të njerëzve dhe të planetit.

BEI Globale, është në rrugën e duhur për të mundësuar të paktën një të tretën e investimeve me vlerë 300 miliardë euro që Global Gateway synon të mobilizojë deri në vitin 2027. Kjo do të ndihmojë në mbështetjen e projekteve që janë të përqendruara në digjitalizim, duke ndihmuar në përballimin e sfidave të ndryshimeve klimatike, energjisë së pastër, kujdesit shëndetësor, arsimit dhe transportit.

BEI Globale na sjell më pranë njerëzve, kompanive dhe institucioneve vendase, duke ndarë njohuritë sektoriale të BEI-t dhe duke ofruar konsulencë të pavarur. Këto shërbime konsulence mund të shoqërojnë produktet financiare të BEI-t, por gjithashtu mund të ofrohen të pavarura nga çfarëdo financimi.

BEI Globale punon përmes bashkëpunimit efikas me partnerët dhe përfituesit tanë, institucionet financiare të zhvillimit dhe shoqërinë civile. Përfundimi: më shumë ndikim nga financimi ynë.





Grupi i BEI-t përbëhet nga Banka Evropiane e Investimeve (BEI) dhe Fondi Evropian i Investimeve (FEI).

BEI është bankë e Bashkimit Evropian. Është një nga kredimarrësit dhe kredihënësit shumëpalësh më të mëdhenj në botë. Me qendër në Luksemburg, banka ka një rrjet zyrash vendore dhe rajonale në Evropë dhe më gjerë.

FEI mbështet bizneset e vogla, duke u përmirësuar aksesin në financa në Evropë dhe në një sërë vendesh jo të BE-së. FEI harton dhe zhvillon kapitalin e sipërmarrjes dhe të zhvillimit, garancitë dhe instrumentet mikrofinanciare për të promovuar novacionin dhe punësimin.

BEI Globale është krahu i zhvillimit ndërkombëtar të BEI-t. Ajo është e përkushtuar në financimin e masave klimatike, novacionit dhe qëndrueshmërisë në mbarë botën.